

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 3230 Rep.

Nr. 872 Kol.



KONTRATË  
SHITJE KUOTASH

Sot më datë 06/08 / 2013, përpara meje noteres Andjano A. Uedeli, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht personat e mëposhtëm:

**Z. Alfred Ibrahim**, shtetas shqiptar, i biri i Ramadanit lindur më 15.12.1973 në Patos, Fier dhe banues në Tiranë, në Adresën Rruga Reshit Çollaku, P. 7 identifikuar nga letërnjoftimi me nr. 027878269, me nr. personal H31215121W, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

**Z. Hekuran Hoxhalli**, shtetas Shqiptar, i biri i Bujarit, lindur më 10.04.1968, në Korçë dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga Naim Frashëri, P. 24, Hyrja 3, Apt. 7, i identifikuar nga letërnjoftimi me numër 029233244, me nr. personal G80410322G madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Të sipërpërmendurit bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", më kërkuan përpilimin e kësaj "Kontrate për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

**Neni 1**

**Palët kontraktuese**

- A.** Shoqëria "Ed Konstruksion" SHPK, e regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT K61625001I, (më poshtë referuar si **Shitësi**), e përfaqësuar nga z. Alfred Ibrahim dhe;
- B.** Shoqëria "Ecuala" SHPK, e regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT L06614601R, (më poshtë referuar si **Blerësi**), e përfaqësuar nga z. Hekuran Hoxhalli.

**Neni 2**

---



### Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja e **49 % (dyzet e nëntë)** të kuotave të kapitalit të shoqërisë, "Mesopotam Energy" SHPK, me NIPT L31917016A ose **49 pjesë gjithsej**, me një vlerë të përgjithshme prej **49 (dyzet e nëntë) lekë**, që përfaqësojnë të gjithë pjesët që shitësi zotëron në shoqërinë "**Mesopotam Energy**" SHPK.

### Neni 3

#### Çmimi i shitjes

Çmimi total i shitjes së kuotave i cili do të paguhet Shitësit nga Blerësi është **ALL 49 (dyzet e nëntë lekë)**.

### Neni 4

#### Mënyra e pagesës

Palët deklarojnë që çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likuiduar prej blerësit jashtë kësaj zyre noterie.

### Neni 5

#### Detyrimet e shitësit

- 5.1. Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, kuota të cilat me nënshkrimin e kontratës i kalojnë Blerësit.
- 5.2. Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.
- 5.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj të fundit.
- 5.4. Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

### Neni 6

#### Detyrimet e Blerësit

6.1. Blerësi ka paguar çmimin e blerjes sipas specifikimeve të kësaj kontrate.

**Neni 7**  
**Gjuha e Kontratës**

Kjo kontratë përgatitet në 4 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Pas përpilimit të kësaj kontrate, Unë noterja e lexova atë me zë të lartë në prani të palëve. Të dyja palët kontraktuese, Shitësi dhe Blerësi, më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e kësaj Kontrate dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e pranuan dhe e nënshkruan atë në praninë time, gjë të cilën unë Noterja e vërtetoj sipas ligjit.

**SHITËSI**

**"Ed Konstruksion" SHPK**



**BLERËSI**

**"ECUALA" SHPK**



**NOTERE**

Ardjana A. MEDIU